

THIRRJE PËR AVOKAT

Për ofrimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje

Tiranë, më 09.02.2022.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e projektit “People in GBV/DV”, “*Angazhimi proaktiv në mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*”, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta kërkon të kontraktojë një avokat për të ofruar ndihmë juridike parësore dhe dytësore për çështje penale të dhunës në familje, në mbështetje të viktimave dhe/ose fëmijëve të tyre.

Preferohen avokatë me përvojë në ndjekjen e çështjeve penale të dhunës në familje dhe formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.

Përshkrimi i detyrave

Avokati/ja do të angazhohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ofrojë ndihmë juridike falas parësore dhe dytësore për viktimat e dhunës në familje;
- Të ofrojnë këshillim, informim dhe përgatisë aktet për rastet e identifikuara;
- Të informojë viktimat e dhunës në familje në lidhje me të drejtat e tyre;
- Të informojnë individët në lidhje me institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problemeve të tyre;
- Të bashkëpunojnë me avokatët/juristët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe stafin e projektit;

Periudha kohore:

Detyrat dhe përgjegjësitë do të përmbushen për një periudhë tre vjeçare.

Kualifikimet e kërkuara të kandidatëve:

- Të këtë mbaruar studimet Bachelor në drejtësi; Studimet master ose ekuivalente me to janë të preferueshme.
- Të këtë të paktën 1 vit përvojë në informim, ndërgjegjësim e këshillim të qytetarëve si dhe në ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e dhunës në familje ose viktimat e dhunës me bazë gjinore në lidhje me të drejtat e tyre;
- Preferohet të këtë përvoja në çështjet penale e vecanërisht në përfaqësimin e mbështetjen e viktimave të veprës penale;

- Të ketë licencë avokati;
- Të njohë shumë mirë paketën microsoft office;
- Të jetë i/e motivuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara.

Përvoja e mëparshme pranë organizatave të shoqërisë civile, në mbështetje të viktimave të dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore me ndihmë ligjore falas është shumë e vlerësueshme.

Pagesa

Fee për shërbimin e ofruar është 200 (Dyqind) Eur në muaj.

Dokumentet:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, e shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe/ose Master, ose ekuivalente me to;
3. Licensën e avokatit;
4. Çdo dokumentacion i nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;
5. Dëshmi e penalitetit;
6. Preferohet të dorëzohet edhe një letër reference nga punëdhënësi të mëparshëm, pedagogë ose partner të tjerë;

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Afati i aplikimeve:

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 22.02.2022, ora 16.00.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën që ta shtyjë afatin e thirrjes ose ta anulojë atë, nëse aplikantët/et nuk përmbushin cilësinë dhe kriteret e kërkuara.